



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 22.12.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të 20.12.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "AS Tech" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Furnizimi, montimi, mirëmbajtja dhe mbushja e kondicionerëve**", Nr. i prokurimit- 632-23-5490-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-068-121, nxjerr:

### V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "AS Tech" SH.P.K., e dt.20.12.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Furnizimi, montimi, mirëmbajtja dhe mbushja e kondicionerëve**", Nr. i prokurimit- 632-23-5490-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-068-121, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 15.12.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 15.12.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

### A r s y e t i m

Me dt.20.12.2023, Operatori Ekonomik "AS Tech" SH.P.K.ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: "**Furnizimi, montimi, mirëmbajtja dhe mbushja e kondicionerëve**", Nr. i prokurimit- 632-23-5490-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-068-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 22.12.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj për Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, nuk qëndron , sepse Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, ka plotësuar kërkesën e autoritetit kontraktues siç është kërkuar në FDT.

I njëjti ka dorëzuar certifikatat, CV, kontratat dhe parakontratat me titullin e projektit për të cilin janë lidhur këto parakontrata.

Autoriteti kontraktues , të gjitha kërkesat për sqarime shtesë i ka bërë në përputhje me LPP-në, prandaj edhe ky pretendim i juaji është i pabazuar.

Pretendimi juaj se Autoriteti kontraktues e demanton vendimin e tij të dt.15.12.2023, nuk qëndron, sepse Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka prezantuar listën e stafit, kurse Operatori ekonomik “INFINIT”, nuk ka prezantuar fare listën e stafit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit të Komunës;  
Te gjitha palëve të interesuara;  
Arkivit të Komunës